


NEWSLETTER

Shtator



**Trajnim për Inteligjencën
Artificiale: Albsig forcon
kapacitetet e stafit drejt
inovacionit teknologjik**

**Albsig të asiston pas çdo
dëmi dhe të dëmshpërblen
në kohë rekord**

**Albsig mbyll 9-mujorin e
parë të vitit 2025 me rritje
të qëndrueshme dhe
performancë të kënaqshme
financiare**

**Sigurimi i nxënësve,
kujdesi që çdo prind
meriton për fëmijën e tij**



PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 31 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP





Trajnim për Inteligjencën Artificiale: Albsig forcon kapacitetet e stafit drejt inovacionit teknologjik

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për zhvillimin profesional të stafit dhe përmirësimin e proceseve të punës përmes teknologjisë, Shoqëria e Sigurimeve Albsig organizoi një trajnim të dedikuar mbi Inteligjencën Artificiale (AI), mbajtur nga eksperti ndërkombëtar Josh Miekley.

Trajnimi, i zhvilluar me pjesëmarrjen e punonjësve të Drejtorisë Qendrore, pati në fokus mënyrat praktike se si inteligenca artificiale mund të përdoret për të rritur efikasitetin, automatizuar detyra të përsëritura dhe për të lehtësuar proceset analitike në përditshmërinë e punës.

Gjatë sesionit, z. Miekley ndau një panoramë të gjerë mbi zhvillimet më të fundit në fushën e AI-së, duke ilustruar raste konkrete se si kjo teknologji po transformon industrinë financiare dhe atë të sigurimeve në mbarë botën.

Pjesëmarrësit u njohën me mjete praktike që mund të ndihmojnë në krijimin e përmbajtjeve më efikase, analizimin e të dhënave, përmirësimin e komunikimit me klientët dhe mbështetjen e inovacionit të brendshëm.

Në vijim të trajnimit, u theksua rëndësia e qasjes etike dhe të përgjegjshme në përdorimin e inteligjencës artificiale, duke respektuar standardet e sigurisë, transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave.

Ky aktivitet shënon një tjetër hap të rëndësishëm në strategjinë e Albsig për të integruar teknologjitë e reja në shërbim të klientit dhe të performancës institucionale, duke nxitur një kulturë inovacioni brenda organizatës.



Trajnime të tilla janë pjesë e vizionit tonë për të investuar jo vetëm në teknologji, por edhe në njerëzit tanë. Inteligjenca Artificiale përfaqëson një mundësi të madhe për të rritur produktivitetin, kreativitetin dhe cilësinë e shërbimit që u ofrojmë klientëve.

Në përfundim, stafi pjesëmarrës vlerësoi trajnimin si një përvojë frymëzuese dhe praktike, që hap horizonte të reja për përdorimin e AI-së në funksion të zhvillimit profesional dhe organizativ të Albsig.



ALBSIG mbyll 9-mujorin e parë të vitit 2025 me rritje të qëndrueshme dhe performancë të kënaqshme financiare



Shoqëria e Sigurimeve ALBSIG sh.a. ka përmbyllur me sukses periudhën Janar — Shtator 2025, duke regjistruar një rritje të qëndrueshme në treguesit kryesorë të performancës dhe duke ruajtur balancën e shëndetshme mes sigurimeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare. Sipas analizës së 9-mujorit, ALBSIG ka ruajtur raportin e sigurimeve vullnetare në nivelin 52.44%, një tregues i rëndësishëm që pasqyron besimin e klientëve në produktet dhe shërbimet me zgjedhje të lirë.

Po ashtu, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kompania ka shënuar një rritje me 10.14%, duke dëshmuar vazhdimësinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe efikasitetin e strategjive të ndjekura gjatë vitit 2025.

Në total, primet e shkruara për periudhën Janar — Shtator 2025 rezultojnë në rritje krahasuar me 9-mujorin e vitit 2024, duke reflektuar rritje të kërkesës për sigurime cilësore dhe menaxhim të kujdesshëm të portofolit të produkteve.



Performanca pozitive është mbështetur kryesisht nga produktet Kasko dhe sigurimet e Zjarrit me Përfitues Bankat, të cilat kanë shënuar rritje të ndjeshme gjatë periudhës. Po ashtu, produktet e Shëndetit, Përgjegjësi, Bashkësigurimit dhe Pronës kanë kontribuar në mënyrë të qëndrueshme në ecurinë e përgjithshme të kompanisë, duke theksuar diversifikimin e portofolit të sigurimeve dhe orientimin drejt nevojave reale të klientëve.

Në përfundim të analizës u theksua se rezultatet e arritura për 9-mujorin e vitit 2025 janë në përputhje me pritshmëritë strategjike dhe përbëjnë një bazë solide për vijimin e vitit me objektiva të qarta për rritje të mëtejshme. Në vijim, ALBSIG mbetet e angazhuar në modernizimin e shërbimeve, forcimin e marrëdhënieve me klientët dhe zhvillimin e produkteve inovative të sigurimit, duke vijuar të konsolidojë pozicionin e saj si një ndër kompanitë më të qëndrueshme në tregun shqiptar të sigurimeve.

Albsig të asiston pas çdo dëmi dhe të dëmshpërblen në kohë rekord

Vetëm gjatë muajve të verës, Albsig ka trajtuar mbi 30 raste dëmsh në pronë dhe biznese, kryesisht si pasojë e stuhive të muajit gusht, përmbytjeve lokale dhe zjarreve pranë zonave të banuara. Çdo rast është trajtuar me transparencë, profesionalizëm dhe kujdes, duke reflektuar filozofinë e kompanisë: të mos lërë asnjë klient vetëm në momentet e vështira.

Sipas të dhënave më të fundit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Albsig rezulton të ketë numrin më të ulët të dëmeve pezull në të gjithë tregun e sigurimeve, me vetëm 348 dosje në fund të muajit gusht 2025.

Ky tregues e pozicionon kompaninë në krye të tregut për efikasitet dhe shpejtësi në përmbylljen e praktikave të dëmshpërblimeve. Ndërkohë gjatë 8 muajve të parë të vitit, kompania ka mbyllur procedurat në kohë rekord dhe ka dëmshpërblyer klientët për 11,381 dosje.

Me mbi 20 vite përvojë në tregun shqiptar të sigurimeve, Albsig vijon të konsolidojë pozicionin e saj si një nga kompanitë më të besueshme dhe më profesionale në vend. Ajo mbetet një partner i qëndrueshëm për individët dhe bizneset shqiptare, duke garantuar mbrojtje reale, zgjidhje të shpejta dhe transparencë të plotë në çdo proces.

Në një periudhë ku ngjarjet natyrore po bëhen gjithnjë e më të shpeshta dhe të paparashikueshme, roli i sigurimeve po merr rëndësi gjithnjë e më të madhe — dhe Albsig, me reagimin e saj të shpejtë dhe efikas, po dëshmon se mbetet një nga shtyllat më të forta të sigurisë financiare në tregun shqiptar.





2025-08-30 12:43:33



08-16-2025 Sat 13:09:12



Sigurimi i nxënësve, kujdesi që çdo prind meriton për fëmijën e tij.

Shkolla është vendi ku fëmijët tanë kalojnë pjesën më të madhe të ditës. Aty ata mësojnë, rriten, krijojnë miqësi dhe bëjnë hapat e parë drejt së ardhmes.

Por, përveç dijes dhe përvojave të bukura, shkolla është edhe një hapësirë ku mund të ndodhin situata të papritura: një rrëzim gjatë lojës, një incident sportiv, apo një aksident i thjeshtë në ambientet e saj.

Si prindër, ne e dimë sa e rëndësishme është t'i mbajmë fëmijët tanë të sigurt. Dhe pikërisht këtu hyn në lojë Albsig, kompania lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri, e cila prej vitesh është sinonim i besimit dhe përgjegjësisë.

Një ofertë simbolike, me vlerë të madhe Albsig ka menduar për qetësinë e çdo familjeje, duke ofruar një policë Sigurimi nga Aksidentet për Nxënësit dhe Studentët me vetëm 500 lekë/vit.

Ky sigurim mbulon aksidentet që mund të ndodhin brenda ambienteve të shkollës, duke i dhënë prindërve sigurinë se nuk janë vetëm në momente të vështira. Një shumë modeste, por me një ndikim të jashtëzakonshëm: përmes saj, fëmijët tanë gëzojnë një mbrojtje shtesë, ndërsa prindërit gjejnë paqen mendore që u nevojitet.



Pse ky sigurim është kaq i vlefshëm?

Ky nuk është një produkt i rastësishëm. Prej vitesh, mijëra prindër në Shqipëri e kanë zgjedhur këtë policë sigurimi, sepse ofron kombinimin e duhur të thjeshtësisë, mbrojtjes dhe besueshmërisë.





Disa nga arsyt kryesore janë:

Qetësi shpirtërore — Asgjë nuk është më e rëndësishme se të dish që fëmija yt është i mbrojtur në orët e shkollës.

Mbështetje konkrete — Në rast të një incidenti, Albsig është aty për të dhënë ndihmën e nevojshme, duke lehtësuar barrën financiare dhe emocionale të familjes.

Besim i fituar ndër vite — Si kompania lidere e tregut të sigurimit, Albsig ka ndërtuar një reputacion të fortë për transparencë, profesionalizëm dhe shërbim cilësor. Kujdesi për të ardhmen fillon sot Sigurimi i nxënësve është shumë më tepër se një dokument financiar. Ai është një akt përgjegjësie dhe dashurie nga prindërit për fëmijët e tyre. Një kujdes i vogël sot, që mund të bëjë diferencën nesër.

Albsig beson se çdo fëmijë meriton të ndjehet i mbrojtur dhe çdo prind meriton të ndihet i qetë. Për këtë arsye, kjo police sigurimi është menduar si një hap i thjeshtë, i përballueshëm dhe i aksesueshëm për të gjithë.

Vetëm 500 lekë/viti
një shifër e vogël për një garanci të madhe


Me Albsig pjesë e Kastrati Group, kujdesi për më të shtrenjtin që keni bëhet më i lehtë dhe më i sigurt.

**Albsig — Lider në sigurime.
Lider në besim.**

KUR KA SIGURI, KA FOKUS.

Sigurimi nga Aksidentet i Nxënësve dhe Studentëve





 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL